



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VI

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 52 të Rregullores së Kuvendit,

Bazuar në Agjendën 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) të miratuara nga Kombet e Bashkuara më 25 shtator 2015 do të nxisin përpjekjet globale për t'i dhënë fund varfërisë, për të mbrojtur njerëzit dhe mjedisin, si dhe ta vendosin planetin në një kurs të qëndrueshëm gjatë pesëmbëdhjetë viteve të ardhshme;

Duke pranuar se OZHQ-të përbëhen nga dimensione ekonomike dhe mjedisore që prekin më tej fushat e reja që përfshijnë çështje të tilla si energjia, rritja ekonomike, pabarazia, konsumi dhe prodhimi i qëndrueshëm, si dhe shoqëritë paqësore;

Duke pranuar se OZHQ-të përbëjnë kornizë të ndërlidhur që përqendrohet në dimensione ekonomike, sociale dhe mjedisore të zhvillimit të qëndrueshëm, përfshirë dispozita për të mobilizuar burimet e nevojshme për të mbështetur zbatimin;

Duke marrë parasysh se Kuvendi i Republikës së Kosovës është zotuar për këtë agjendë të re globale përmes Planit Strategjik të Kuvendit, i miratuar në Qershor 2016;

Derisa paragrafi 45 i Agjendës 2030 kujton "rolin thelbësor të parlamenteve nëpërmjet miratimit të legjislacionit dhe miratimit të buxheteve dhe rolit të tyre në sigurimin e përgjegjësisë për zbatimin efektiv të angazhimeve tona", si dhe në paragrafin 79, roli i parlamenteve në mbështetjen e "shqyrtimit të rregullt dhe gjithëpërfshirës të progresit në nivel kombëtar";

Duke marrë parasysh se Qeveria e Republikës së Kosovës do të duhet të përkthejë OZHQ-të globale në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit (2016-2021) të miratuar në janar 2016, dhe në përputhmëni me specifikat e vendit tonë përfshirë edhe rreth aspektit kohor;

Duke e përkujtuar se Deklarata e Konferencës së 4-të Botërore e Kryetarëve të Parlamenteve e miratuar më 2 shtator 2015 ofron udhëzime të mëtejme për Kuvendin e Republikës së Kosovës rreth zbatimit të agjendës së re globale;

Me ndërgjegje të mirë se përmirësimi i ekonomisë dhe i mirëqenies së gjithë qytetarëve të Kosovës, përmes arritjes së OZHQ-ve do të ndihmojë vendin të bëhet burim i stabilitetit përbrenda si dhe në rajon;

Me besim se arritja e OZHQ-ve do të përparoj proceset e integritimit në BE, si dhe bashkëpunimin rajonal e ndërkombëtar;

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën plenare të mbajtur më 25 janar 2018, me propozim të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, nxori këtë:

**REZOLUTË**  
**për miratimin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm**

1. Miratohen Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (ose Agjendën 2030) bazuar në Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme A / RES / 70/1 të miratuar nga 193 liderë nga mbarë bota më 25 shtator 2015, dhe të lidhura me Deklaratën e Konferencës Botërore të Kryetarëve të Parlamenteve si pikat kryesore të referencës mbi të gjitha politikat për zhvillim të qëndrueshëm;
2. Do të angazhohet për të ndihmuar zbatimin e kësaj kornize të re globale nëpërmjet miratimit të legjislacionit, duke përfshirë edhe miratimin në kohë të buxhetit të nevojshëm;
3. Rishikon kur është e nevojshme strukturën ekzistuese të komisioneve dhe të gjitha proceset e brendshme ashtu që në mënyrë efektive dhe koherente të përfshihen të gjitha Objektivat relevante përmes Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale si Komision kryesor, dhe Komisionet tjera relevante që përfshijnë : Komisionin Parlamentar për Integrimin në BE, Komisionin Parlamentar për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi, Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Zhdukur dhe Peticione, Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Planifikimit Hapësinor, Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;
4. Do të përcjellë zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Qeverisë për Zhvillim, strategjive të integrimit në BE dhe strategjive të tjera që integrojnë OZHQ-të, duke përfshirë mbajtjen e takimeve të rregullta me shoqërinë civile, sektorin privat dhe qytetarët në përgjithësi;
5. Kërkon nga Qeveria raportim mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit (2016-2021), duke përfshirë edhe rreth objektivave të OZHQ-ve përmes një rishikimi të plotë vjetor nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;
6. Shqyrton raportet kombëtare të progresit që do të mund të paraqiten nga Qeveria në Kombet e Bashkuara si pjesë e shqyrtimit global në Forumin e Nivelit të Lartë të OKB-së për Zhvillim të Qëndrueshëm;
7. Organizon, në fund të çdo viti, mbledhje me Qeverinë, komunitetin ndërkombëtar, organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët në përgjithësi, për debat publik rreth statusit të progresit të Synimeve relevante të OZHQ-ve për zhvillimin e vendit tonë; 8. Kjo Rezolutë hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës

Nr. 06-R- 001  
Prishtinë, 25.01.2018

Kryetari i Kuvendit:

  
**Kadri VESELI**

Rezoluta u dërgohet:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Grupeve Parlamentare,
- Arkivit të Kuvendit.